

# STATUT

## I SHOQERISE “CS Uniforma” sh.p.k

Themeluesit deklarojne se kane krijuar shoqerine italo- shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emrin “ CS Uniforma ” sh.p.k..

### KREU I

Dispozita te pergjithshme

#### **Neni 1**

Themeluesit dhe ortaket e shoqerise ” CS Uniforma” sh.p.k. jane :

- **Lucia CATALANO** e bija Antonio Catalano dhe e Anna Maria Paziienza lindur ne San Severo me 29.07.1980 banues ne , Rruga “Rossa Guido 101” , San Severo , Foggia ,Itali identifikuar me Karten e Identitetit Nr AZ 0625184
- **Savino CIANCI** i biri i Felice Cianci dhe Celeste COCCO lindur ne Stornarella Foggia me 11.02.1964 banues ne , Rruga “Regina Giovanna ” Nr 68 Carapelle Itali identifikuar me Karten e Identitetit Nr AV 3584690

#### **Neni 2**

Shoqeria “ CS Uniforma ” sh.p.k. krijohet si person juridik shqiptar dhe vepron si i tille nga dita e rregjistrimit ne Q K B dhe paisjes me lejen perkatese nga organet tatimore.

Te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga shoqeria , do te permbajne pervec emertimit “CS Uniforma ” edhe fjalet ‘ shoqeri me pergjegjesi te kufizuar “ ose inicalet shpk. Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas kontrates se themelimit, te Statutit , dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi.

#### **Neni 3**

Selia e shoqerise eshte ne qytetin Durres Republika e Shqiperise me adrese , Rruga “ Mujo Ulqinaku “ ,Lagja Nr 5 , Pallati Nr 1889 , Zona Kadastrale 8513 Durres , Organet kompetente do te mund te krijojne apo te mbyllin seli dytesore, filiale,axhensi, perfaqesi , zyra ne Shqiperi dhe jashte vendit .

#### **Neni 4**

Vendbanimi i ortakeve per cdo raport me shoqerine, eshte ai qe rezulton ne librin e ortakeve,cdo ndryshim i bere lidhur me vendbanimin e ortakeve do te shenohet ne ate liber. Shoqeria ka vulen e saj te rumbullaket ose katrore me mbishkrimin shoqeria “CS Uniforma ” sh.p.k. Durres.

## **Neni 5**

Veprimtaria e shoqerise do te vazhdoje per nje periudhe 30( tridhjet ) vjet, periudhe e cila do te mund te shtyhet apo te perfundoje me pare me vendim te ortakeve ne perputhje me ligjet.

## **Neni 6**

### **Objekti i veprimtarise**

Sigurimi i shërbimeve IT , konsulencë të veçantë, projektim, programim dhe prodhim të programeve kompjuterike, instalim dhe ndihmë për përdoruesit e fundit, montimin, riparimin dhe shitjen e pajisjeve informatike, shërbimeve të internetit dhe intranet, krijimin e faqeve të internetit, e-commerce; zhvillimi i programeve dhe dokumentacionit për paraqitjen e aplikacioneve për hua të subvencionuara dhe jo të subvencionuara, shtetërore, rajonale, komunitet dhe të çdo organi tjetër publik dhe / ose privat në emrin e vet dhe në emër të palëve të treta.

Te ofroje sherbimi marketingu ne fushen e reklamave mbeshtetur ne teknologjine dixhitale  
Shoqeria ofron sherbim te kualifikuar ne promovimin e iniciativave në fushën e komunikimit dhe reklames .

Aktivitete konsulence që synojnë ideimin, vlerësimin, iniciativat e trajnimit, në bashkëpunim me subjektet vendore në kontekstin e programeve të parashikuara nga rregulloret rajonale dhe kombëtare në fushën e politikave sociale, të punësimit dhe zhvillimit;  
furnizimi i shërbimeve të informacionit, shërbimeve të internetit, rrjetëzimit edhe përmes telekomunikacionit;

Trajnime te stafit mësimor, përmes realizimi i kurseve të formimit profesional, ne perputhje me politikat e Ministrise se Arsimit .

## **KREU II**

### **Kapitali themeltar dhe kuota**

## **Neni7**

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet vetem nga kontributi ne para ne Shumen 10.000 ( dhjetemije ) leke Ky kapital eshte i ndare ne 2 kuota.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise ndahet si vijon :

Ortaku **Lucia CATALANO** zoteron 1 kuote 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 5.100 leke .

Ortaku **Savino CIANCI** zoteron 1 kuote me 49 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 4.900 leke.

### **KREU III**

#### **Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar**

##### **Neni 8**

Pjeset nominative te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve ne rruge trashegimie tek paraardhesit dhe pasardhesit si dhe ndermjet ortakeve.

Ne te gjitha rastet e transferimit , çmimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar do te caktohet sipas vleres aktuale te bilancit te shoqerise ne momentin qe do te behet transferimi.

### **KREU IV**

#### **Administrimi dhe drejtimi i shoqerise**

##### **Neni 9**

- Shoqeria ka si Administrator ortakun , **Lucia CATALANO** .  
Periudha fillestare e emerimit te Administratorit te Shoqerise eshte 5 ( pese ) vjet , me te drejte rimerimi .  
Adminstratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga Administrimi i shoqerise duke i drejtuar nje njoftim me shkrim Asamblese se pergjithshme te Ortakeve .

#### **Kompetencat e administratorit**

##### **Neni 10**

Administrator i shoqerise Z **Lucia CATALANO** ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo kohe ne emer te shoqerise .

Ai ushtron kompetencat e tij brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kufizohet per kompetenca qe ligji ia jep shprehimisht asamblese se ortakeve.

Z **Lucia CATALANO** perfaqeson shoqerine para te treteve ne Gjykate , ne maredhenie kontraktuore , disponon pasurine ne interes te saj.

## KREU V

### Asambleja e ortakeve

#### Neni 11

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise. Vendimet e saj protokollohen.

Ne kete Shoqeri Asambleja perbehet nga :

- Ortaku **Lucia CATALANO** zoteron 1 kuote qe perfaqson kontributin ne pjese te 51 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise .
- Ortaku **Savino CIANCI** zoteron 1 kuote qe perfaqson kontributin ne pjese te 49 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

### Kompetencat e asamblese

#### Neni 12

Asambleja e pergjithshme e ortakeve ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe ajo i shikon te arsyeshme dhe kerkon ne cdo kohe te njihet me dokumentacionin e plote te shoqerise

Asambleja e pergjithshme e ortakeve emerion dhe shkarkon administratorin, keshillin administrativ, ekspertet kontabel te autorizuar, cakton kompetencat, sektoret qe do te mbulojne dhe angazhimet e tyre.

Asambleja merr vendime per transferimin e kapitalit. sipas procedures te percaktuar ne Nenin 8 te Statutit.

Merr vendime per zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise, per zgjerimin e objektit merr vendime per ndryshimin e tipit te shoqerise ne vartesi te kapitalit themeltar.

Merr vendime per ndryshimin e Statutit, plotsimin e tij, ne rastet kur ajo e cmon te arsyeshme si dhe ne vartesi te ndryshimeve te legjislacionit shqipetar veprimtarise se saj, per zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit themeltar

Vendimet e rendesishme qe kane te bejone me maredhenie me te tretet , per zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit , ndryshimin e Statutit apo emeriti e Administratorit kurdohere merren me shumice te aksionereve qe perfaqsojne me shume se 70 % te kuotave te kapitali themeltar te Shoqerise .

Asambleja e pergjithshme e ortakeve ka te drejte te ngreje padi perpara Gjykates Kompetente per shfuqizimin e Vendimit te Administratorit si pasoje e shkeljes se rende te Ligjit ose te Statutit .

### Ndryshimet e Statutit.

### **Neni 13.**

Ndryshimet e Statutit dhe te Aktit te themelimit vendosen nga asambleja e pergjithshme e ortakeve.

### **Zmadhimi i kapitalit themeltar.**

### **Neni 14.**

Zmadhimi I kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve, pasi ortaket kane deklaruar ,kane nenshkruar dhe kane shlyer(derdhur)pjeset e kapitalit qe do te zmadhohet, ne formen e kontributeve ne natyre ose ne para.

Zmadhimi I kapitalit ne para nuk perfaqson kontributet ne sherbime.

Ne cdo rast zmadhimi I kapitalit themeltar shoqerohet me nje vendim asambleje per ndryshim ne aktin e themelimit dhe ne Statut,ku percaktohet shprehimisht pjesmarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar te zmadhuar si dhe kuota e re.

### **Zvoglimi I kapitalit themeltar**

### **Neni 15 .**

Zvoglimi I kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve.

Zvoglimi I kapitalit themeltar e prek ortaketun ne ate mase ,sa jane pjeset e kapitalit qe ata perfaqsojne

Kur asambleja merr vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar(qe motivohet nga humbjet e rezultuara te shoqerise) nen limitin e parashikuar ne Kodin Tregtar te Shqiperise per sh.p.k.-te atehere ky vendim do te shoqerohet me keto veprime:

1.Ndryshimi i tipit te shoqerise.

2.Ndryshimi i Statutit.

3.Publikimi dhe njoftimi i te treteve me te cilet shoqeria ka maredhenie kontraktuale si dhe kreditorët.

Kur asambleja e ortakeve miraton nje projekt vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar, qe nuk motivohet nga humbjet, kreditorët, kredia e te cilene eshte dhene para dates se publikimit te ndryshimeve perkatese ne Statut, mund te kundershtojne zvoglimin e kapitalit brenda nje muaji nga kjo date ne rruge gjyqsore.

### **Neni 16**

### **Shndrrimi i shoqerise**

Shndrrimi i kesaj shoqerie ne nje tip tjeter shoqerie, behet me vendim te asamblese te ortakeve. Ky shndrrim eshte i detyrueshem per shoqerine kur kapitali themeltar bie nen limitin e domosdoshem per sh.p.k. limit ky i percaktuar ne Ligjin Per Shoqerite Tregtare.

#### **Neni 17**

Shndrrimi i kesaj shoqërie në shoqëri anonime bëhet me vendim të asamblesë të ortakeve duke zbatuar rregullat për ndryshimin e Statutit me kusht që paraprakisht të jetë hartuar dhe miratuar bilanci i dy viteve të fundit të aktivitetit të shoqërisë.  
Për marrjen e vendimit për transformimin e shoqërisë, caktohet nga ortaket, eksperti kontabil i autorizuar për përgatitjen e raportit mbi gjendjen e shoqërisë.

### **KREU V**

#### **Rezerva e domosdoshme, shpërndarja e fitimit, dividendet**

#### **Neni 18**

##### **Rezerva e domosdoshme**

Shoqëria "CS Uniforma" sh.p.k. nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar, pasi të zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, është detyruar të lere nënë një shumë me vlerë minimale 1/20 e fitimit, e cila formon fondin rezervë, të quajtur "rezerva e domosdoshme".  
Dispozita e mësipërme nuk është e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrijë 1/10 e kapitalit themeltar.

#### **Neni 19**

Fitimi që do të shpërndahet përbehet nga fitimi i vitit financiar, nga i cili është zbritur "rezerva e domosdoshme" sipas Nenit 23 të Statutit si dhe janë zbritur ose shtuar humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e mëparshme.  
Sipas rastit asambleja e ortakeve, mund të vendosë për shpërndarjen e shumave të lëna menjëherë për rezervën me kusht që të mos preket "rezerva e domosdoshme" në masën e parashikuar në Nenin 19 të Statutit. Vendimi tregon shprehimisht llojin e rezervës ku janë marrë këto shuma.  
Përveç rasteve të zvoglimit të kapitalit themeltar, nuk mund të bëhet asnjë shpërndarje, nëq.s. kapitalet mbas kesaj shpërndarjeje do të beheshin me të vogla se shumën e kapitalit themeltar plus „rezervën e domosdoshme“ të përcaktuar në Statut.

#### **Neni 20**

##### **Përcaktimi i dividendëve**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të shumës që do të shpërndahet asambleja përcakton pjesën që i takon çdo ortakut në formë dividenti. (ndarja e fitimit në raport me kuotën që zoteron çdo ortak).  
Shoqëria ka të drejtë të japë dhe paradhenie vlera e të cilave ka rrjedhur nga vitet financiare të mbyllura ose në vazhdim, vlera këto të derdhura për mbylljes së vitit financiar, me kusht që:

a. Të mos preket "rezerva e domosdoshme"

b. Shuma që ka depozituar shoqëria si rezervë, të jetë e paktën e barabartë me paradheniet e shpërndara

c. Te perpilohet nje raport nga esperti kontabel, i cili konfirmon se fitimet neto te realizuara deri ne ato kohe jane me te medha se paradheniet e shperndara  
Shperndarja e paradhenieve vendoset nga asambleja ose administratorie Ne vendim percaktohet shuma dhe data e kthimit

## KREU VI Pavlefshmeria dhe prishja e shoqerise

### Neni 21

#### Rastet e pavlefshmerise

Pavlefshmeria e shoqerise, (Aktit te themelimit ose Statutit) si dhe pavlefshmeria e akteve te tjera te saj ( vendimeve te asamblese, raporteve te ekspertit kontabel te autorizuar, veprimeve te administratorit etj.) mund te rezultojne vetem nga shkelja e nje dispozite urdheruese apo ndaluese te Ligjit Nr. 9901 date 194.04.2008 . “Per Shoqerite Tregetare” si dhe parashikimeve te bera ne ndryshimin e ketij Ligji me Ligjin 129 /2014 , ne Nenin 1 te tij , ose e legjislacionit ne fuqi per kontratat dhe veprimet juridike te parashikuara ne Kodin Civil Pavlefshmeria e shoqerise mund te rezultojne dhe nga paaftesia e ortakeve

### Neni 22

#### Prishja e shoqerise

Prishja e shoqerise shpallet ,sipas rastit nga asambleja e ortakeve te shoqerise vetem ne rastet e poshteshenuara:

- a. Me perfundimin e afatit te parashikuar ne Kontraten e Themelimit dhe ne Statut neqoftese ortaket nuk marrin vendim per zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise. Me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.
- b. Me humbjen e ½ te kapitalit themeltar, kur ky i fundit bie ne limitin e parashikuar per sh.p.k.-te ne Kodin Tregetar, rast per te cilin zbatohet kjo procedure.

Ne rast se kapitalet e shoqerise , per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se ½ e kapitalit themeltar ortaket brenda 4(kater) muajve nga konstatimi i kesaj gjendje, vendosin per mundsine e prishjes se shoqerise  
Ne rast mosveprimi nga ana e asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen , per shkaqet e percaktuara ne Nenin 99 pika 1 , gerrat a, c, d, dh te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 ndryshuar me Ligjin 129/2014 , cdo person i interesuar mund ne cdo kohe ti drejtohet Gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise .  
Ne rast se nuk shpallet prishja ,shoqeria detyrohet te zmadhoje kapitalin themeltar me nje vlere jo me te vogel se vlere e humbjeve te pambuluara nga rezervat, duke patur parasysh dhe limitin e parashikuar nga Kodi Tregetar per sh.p.k-te.  
Ky operacion duhet te kryhet brenda vitit financiar.

Neni 23

**Likuidimi**

Ne te gjitha rastet, kur me vendim gjykate shpallet pavleshmeria absolute apo relative e shoqerise ,si dhe ne rastet kur asambleja merr vendim per prishjen e saj ( raste te parashikuara ne Statut),fillon procesi i likuidimit te shoqerise,proces i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin Tregetar Shqipetar.

**ORTAKET E SHOQERISE**

LUCIA CATALANO



SAVINO CIANCI



Porbthen  
Reimant Tolle



Date 08/07/2020